

MBI COSTIN

I dedikuar për t'i shërbyer një shoqërie të larmishme, shërbimi për emigrantët COSTI është një agjensi multikulturale komunitare që ofron shërbime pune, edukimi, rivendosje dhe shërbime sociale për të gjitha komunitetet e imigrantëve, kanadezëve të rinj dhe personave në nevojë për ndihmë.

COSTI përpiket të jetë në pararojë të shërbimit ndaj komunitetit duke përdorur metoda krijuese, aktive dhe që kanë klientët në qendër, gjatë planifikimit, zhvillimit dhe kryerjes së shërbimeve. Programet tona mundësojnë që të sapoardhurit në Kanada të përdorin aftësite e tyre, të mësojnë të tjera aftësi dhe të marrin pjesë aktivisht në të gjitha aspektet e jetës kanadeze, pavarësisht nga pengesat e gjuhës apo të kulturës së tyre.

COSTI ka 17 zyra të shpërndara në Toronto, në rajonin e York dhe Peel, dhe ofron shërbime në më se 60 gjuhë. Vitin e kaluar, mbi 39 000 persona gjetën ndihmë nga COSTI.

Shërbimet dhe programet përfshijnë:

- Shërbime punësie të specializuara për individë të shkolluar në vende të tjera si edhe informacion dhe referenca në entet përkatëse, vlerësim dhe këshillim punësimi, vende pune të mundshme, trajnim për kërkim pune, dhe shërbime punësie për të rinj.
- Programe për mësimin e gjuhës angleze (ESL) dhe të aftësive të tjera (LINC)
- Shërbime të rivendosjes që përfshijnë orientimin, informacionin, këshillimin dhe interpretimin kultural për emigrantët e sapo ardhur.
- Mbështetje e pas-vendosjes për emigrantët e ardhur dhe që vazhdojnë të kenë nevojë për shërbime sociale ose qeveritare.
- Shërbime vendosje dhe strehimi për refugjatë të sponsorizuar nga qeveria.
- Shërbime këshillimi për familjet dhe për shëndetin mendor.
- Mështetje strehimi për familje që rrezikojnë të nxirren nga shtëpia ose për ato që janë në një situatë strehimi të pafavorshme.
- Shërbime rehabilitimi për punëtorë që kanë handikape mendore apo fizike.
- Ndihmë për gra imigrante në kapërcimin e pengesave në jetën e tyre dhe në gjetjen e mundësive të reja.
- Shërbime të veçanta për nevojat e të moshuarve në ndihmë të një jete të kënaqshme dhe dinjitoze.
- Shërbime përkthimi (me shkrim dhe me gojë).

COSTI bën çdo përpjekje për të krijuar mundësi shërbimi të barabartë për individë nga çdo anë e botës. Për të mësuar më shumë mbi shërbimet e vendosjes në gjuhën tuaj, shkoni tek seksioni i Programeve dhe Shërbimeve në sitin tonë.

MISIONI

COSTI ofron shërbime shoqërore, edukimi, dhe punësi në ndihmë të të gjithë emigrantëve në zonën e Torontos që të arrijnë një nivel pavarësie në jetën dhe shoqërinë kanadeze.

COSTI, i themeluar nga komuniteti italian në Kanada në kohën e pas luftës për të plotësuar nevojën e madhe të emigrantëve për ndihmë, sot është një agjensi multikulturale që ndihmon të gjitha komunitetet e emigrantëve në nevojë të shërbimeve të stabilizuara.